

Në bazë të nenit 48 të Ligjit për nëpunësit e administratës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe nenit 2 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e konkursit intern, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes për avancime, mënyrën e realizimit të përzgjedhjes administrative dhe për realizimin e intervistës si dhe mënyrën e vlerësimit me pika të notimit dhe për numrin maksimal të pikave gjatë procedurës së përzgjedhjes, në varësi prej kategorisë së vendit të punës për të cilin është shpallur konkursi intern ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 11/2015), Drejtor i NP "Parqe dhe gjelbërime" shpall:

## **KONKURS INTERN me nr. 01 /2019**

### **për plotësimin e vendit të punës të nëpunësit të administratës përmes avancimit**

- 1. Këshilltarë – koordinator, me shifrën 238 A/ KDR. 01.02.V01.018, niveli **V01**, në Seksionin për llogaritjet e pagave, Sektori – Puna financiare, **1 (një) realizues.****

#### **Kushte të posaçme:**

**Kualifikime profesionale** – për nivelin V1, niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës Maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar nivelin VII/1 (Shkencat e ekonomisë, Administrata dhe drejtoria publike, Shkencat organizative dhe udhëheqja (menaxhment)).

**Përvoja e punës** – për nivelin V1 së paku tre vjet përvojë pune në profesionin përkatës.

#### **Kompetencat e përgjithshme të nevojshme punuese për nivelin e avancuar:**

- Zgjidhja e problemeve dhe vendosja për punët nga fushëveprimi i tij;
- Mësimi dhe zhvillimi;
- Komunikimi;
- Realizimi i rezultateve;
- Puna me të tjerët / puna ekipore;
- Vetëdija strategjike;
- Orientimi ndaj klientëve / palët e përfshira dhe
- Menaxhimi financiar.

#### **Kompetencat e posaçme të nevojshme të punës:**

- Njohja aktive e njëjës prej tre gjuhëve të cilat më shpesh shfrytëzohen në Bashkimin Evropian (gjuha angleze, gjuha frënge, gjuha gjermane);
- Njohja aktive e programeve kompjuterike dhe e punës në zyre.

**Orari i punës:** nga e hëna deri të premten, nga ora 07:00 – 15:00, 40 orë në javë.

**Neto paga mujore:** 25.480 denarë.

Kandidati i cili aplikon në këtë konkurs intern, duhet ti përmbush edhe këto kushte të përgjithshme vijuese, të përcaktuara me nenin 31, paragrafi (1) të Ligjit për nëpunësit e administratës:

- të jetë nënshtruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- në mënyrë aktive të shfrytëzojë gjuhën maqedonase;
- të jetë i moshës së pjekur;
- të posedojë aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Në konkursin intern mund të paraqiten nëpunësit e administratës, të punësuar në NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, të cilët i përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të lartpërmendura për plotësimin e vendit të punës, të përcaktuara për nivelin përkatës me këtë ligj dhe me aktin e sistematizimit, si dhe:

- Të jenë vlerësuar me notën “A” ose “B” gjatë vlerësimit të fundit;
- Të jenë në vendin e punës në nivelin e drejtpërdrejtë më të ulët ose të jenë në vendin e punës në suaza të kategorisë së njëjtë me vendin e punës për të cilin shpalljet konkursi intern;
- Të ketë kaluar së paku dy vite në vendin aktual të punës, dhe
- Të mos i jetë shqiptuar masa disiplinore gjatë vitit të fundit, para shpalljes së konkursit intern.

Së bashku me fletëparaqitjen, përsëri dëshmime për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, kandidatët mund ti dorëzojnë edhe këto dëshmi:

- Vërtetime për trajnimet e realizuara me sukses;
- Vërtetime për realizimin e suksesshëm të mentorimeve.

Afati i parashtrimit të fletëparaqitjeve është 5 (pesë) ditë, llogaritur nga dita e shpalljes së konkursit.

Kandidatët e interesuar, duhet të parashtrojnë fletëparaqitjen e plotësuar dhe dëshmitë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës (nëse të njëjtit më parë nuk i kanë dorëzuar në dosjen personale), përmes arkivit të NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup deri te Seksioni për menaxhim me resurset njerëzore, në adresën NP “Parqe dhe gjelbërime” – Shkup, bul. Ilinden nr. 104, si dhe deri te adresa zyrtare elektronike [covecki.resursi@parkovi.com.mk](mailto:covecki.resursi@parkovi.com.mk) me shenjën “për konkursin intern”.

Fletëparaqitjet e dorëzuara me vonesë dhe të plotësuar në mënyrë të parregullt, nuk do të jenë lëndë e shqyrtimit.

Procedurën do ta realizojë Komisioni për përzgjedhje për avancime, e formuar nga ana e Drejtorit të NP “Parqe dhe gjelbërime” - Shkup.

**VËREJTJE:** Kandidati i cili ka parashtruar të dhëna të rreme do të diskualifikohet nga procedura e mëtutjeshme.

**NP “Parqe dhe gjelbërime”**

**Drejtori**

---

**Ardijan Muça**